



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



RAPORTI VJETOR

për punën e
Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në vitin 2014

Mars 2015



Raporti vjetori për punën e Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës në vitin 2014 është hartuar në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr 145/10, 136/11 dhe 41/2014), ku është përcaktuar detyrimi për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës që më së voni me 31 mars të vitit të ardhshëm, të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të parashtron Raportin vjetor për punën e Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin e kaluar.

Në raportin vjetor janë të përfshirë informacione të detajuara për kompetencat që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e konkurrencës dhe Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, si dhe informacione detale për punën materialo-financiar të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në këtë raport është dhënë një pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë vitit 2014. Me këtë rast i është dhënë një fokus i veçantë aktiviteteve të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës (lëndët sipas të cilit ka vepruar Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës në procedurën administrative dhe lëndët sipas të cilit ka vepruar Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës në procedurën administrative, analizat përgatitura në treg dhe mendimet e dhëna) dhe aktivitetet lidhur me zbatimin e Ligjit për Kontroll të Ndhmës Shtetërore (para së gjithash vendimet e miratuara në procedurën e vlerësimit të kompatibilitetit të ndihmës shtetërore), si dhe hartimin e rregullave tjerë që janë në kompetencë të Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Në këtë raport janë paraqitur aktivitetet në të cilën Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i ka realizuar gjatë vitit 2014 në planin ndërkombëtar. Në fund të raportit është dhënë një pasqyrë e punës financiare të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2014.



TABELA PËRMBLEDHËSE

PARATHËNIE.....	5
A. KONKURRENCA	Error! Bookmark not defined.
1. Korniza ligjore	Error! Bookmark not defined.
1.1 Ligji për mbrojtjen e konkurrencës	Error! Bookmark not defined.
1.2 Aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.....	Error! Bookmark not defined.
1.3 Udhëzimet, synimet dhe broshurat për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës .	Error! Bookmark not defined.
2. Aktivitetet e Komisionit në fushën e mbrojtjes së konkurrencës	8
2.1 Procedurat administrative dhe kundërvajtëse që kryhen (zhvillohen) nga Komisioni.....	Error! Bookmark not defined.
2.2 Marrëveshjet, vendimet dhe sjellja e harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve.....	9
2.3 Keqpërdorimi i pozitës dominuese	12
2.4 Shkeljet të rënda në procedurat për vlerësimin e përqendrimeve	14
2.5.Vlerësimi i përqendrimeve të ndërmarrjeve	15
2.6 Bashkëpunimi i Komisionit me trupat rregullator dhe organet tjera shtetërore.....	21
2.7 Mendimet e dhëna nga Komisioni.....	21
3.Transparenca	22
B. NDIHMA SHTETËRORE	22
4. Korniza juridike	22
4.1 Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.....	22
4.2 Aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.....	23
5. Parimi metodologjik.....	24
5.1 Ligji për Kontroll e Ndhmës Shtetërore	24
6. Aktivitetet e Komisionit	25
6.1Vendimet/aktvendimet e miratuara për ndihmën e ndarë shtetërore	25
6.2 Ndhma shtetërore sipas instrumenteve	28
6.3 Mendimet e Komisionit	28
7. Komentet dhe konkuzionet	29
V. INTEGRIMI NË UE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	30
8. Integrimi në UE.....	30
8.1 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në fushën e antitrust dhe ndihmës shtetërore	30



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



8.2 Bashkëpunimi ndër-dikasterial në planin e integritit evropian.....	31
9. Bashkëpunimi ndërkombëtar	32
9.1. Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral.....	32
9.2. Bashkëpunimi bilateral.....	33
9.3. Bashkëpunimi multilateral.....	33
G. KAPACITETI ADMINISTRATIV I KOMISIONIT	34
D. KONKLUZË.....	34
GJ. RAPORTI FINACIAR.....	36



PARATHËNIE

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) është themeluar në vitin 2005 si një organ autonom, kolegial dhe si një organ i pavarur shtetëror, i cili është përgjegjës për punën e tij vetëm para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 145/11 dhe 41/14) qëllimi i të cilit është zbulimi, parandalimi dhe sanksionimi i formave të ndryshme të rrezikut, parandalimit dhe prishjes së konkurrencës në treg dhe Ligji për Kontroll të Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10) qëllimi i të cilit është mbikqyrja e çdo forme të ndihmës shtetërore që është ndarë në Republikën e Maqedonisë, në funksion të sigurimit të konkurrencës së lirë dhe tregut konkurrues, i liruar nga ndikimi i ndërhyrjes së shtetit.

Në bazë kompetencave, Komisioni merret me procedurat administrative dhe me procedurat e kundërvajtjes dhe për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës shqipton gjobë si një sanksion për kundërvajtje, sipas dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje.

Gjatë vitit 2014, Komisioni ka miratuar gjithsej 41 vendime në procedurë administrative të cilat kanë të bëjnë me kontrollin e përqendrimeve dhe 11 vendime që kanë të bëjnë me kontrollin e ndihmës shtetërore. Nga gjithsej 30 vendime për përqendrim, në 29 vendime është konstatuar se përqendrimet janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërsa në një vendim Komisioni konstaton se përqendrimi nuk bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Sa i përket vendimeve për kontrollin e ndihmës shtetërore, te 6 vendimet konstatohet se masat e përfshira në njoftimet që i dorëzohen Komisionit nga dhënësi i ndihmës shtetërore paraqesin ndihmë shtetërore në bazë të Ligjit për Kontroll të Ndhmës Shtetërore, ndërsa te 5 vendimet e tjera Komisioni konstaton se masat e përfshira në njoftim paraqesin ndihmë me rëndësi të vogël (ndihmë de minimis). Në mënyrë plotësuese, Komisioni ka dhënë 4 mendime sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe 19 mendime sipas Ligjit për kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Gjatë vitit 2014, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit, ka miratuar 10 vendime në procedurë kundërvajtës dhe shqiptoi një gjobë të përgjithshme prej 233.530.047,00 denarë. Pastaj, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në 4 vendime konstatoi ekzistimin e një marrëveshje të ndaluar (kartele të furnizimit publike të barnave dhe shitjes së energjisë elektrike) dhe i shqiptoi një gjobë të përgjithshme në shumën prej 230.673.897,00 denarë, në 4 vendime konstatoi ekzistimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese të ndërmarrjeve komunale publike dhe shqiptoi një gjobë në shumën prej 1.503.150,00 denarë dhe në 2 vendime konstatoi shkelje për shkak të mosdorëzimit të



njoftimit për përqendrim dhe shqiptoi një gjobë të përgjithshme prej 1.353.000,00 denarë. Shuma e përgjithshme e gjobës në vitin 2013 është 1.076.300,00 denarë.

Komisioni, duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion është i kënaqur me vëllimin e aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura në fushën e mbrojtjes së konkurrencës dhe kontrollit të ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë në vitin 2014. Konfirmim i kësaj është raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2014 në fushën antitrust dhe ndihmën shtetërore, në të cilin thuhet se, „është bërë përparim i mirë në fushën e politikës së konkurrencës”, respektivisht përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë të avancuar “. Përgatitja e këtij raporti vjetor, përveç që paraqet një detyrim ligjor sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, paraqet edhe një mënyrë të dobishme për të siguruar një transparencë në punën e Komisionit, si dhe për njohjen e punës së Komisionit para ekspertëve dhe biznesit publik në Republikën e Maqedonisë. Në fakt, ky raport ka për qëllim vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Komisioni në vitin 2014 të sistematizohen në një vend edhe pse ato publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e internetit të Komisionit.

Shkup , 30 Mars 2015

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Blagoj Çurlinov- Kryetar

Çedomir Krlevski- Anëtar¹

Naser Zharku- Anëtar

Snezhana Kostadinovska-Milosheska- Anëtar

Afet Avmedoski- Anëtar²

A. KONKURENCA

¹ Kryetar i Komisionit për Vendimarrje për Kundërvajtje (neni 30 i ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës)

² Më 15.09.2014, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi një Vendim për shkarkimin e Afet Avmedoski nga detyra- anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me kërkesë të tij. Nga 15.09.2014 deri më sot nuk është emëruar një anëtar i ri në Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe i njëjti operon me katër anëtarë.



1. Korniza ligjore

Kornizën ligjore në mbrojtjen e konkurrencës e përbën Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe aktet nënligjore të cilat janë miratuara në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

1.1 Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 04/05, 70/06 dhe 22/07), ishte në fuqi deri 13.11.2010. Më 13.11.2010 hyri në fuqi Ligji i ri për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), i cili është plotësisht i harmonizuar me të drejtën evropiane për mbrojtjen e konkurrencës gjegjësisht nenet 101, 102, 106 dhe 107 të Marrëveshjes për funksionimin e UE-së dhe akteve të UE-së: 32003R0001, 32004R0773, 32004R0139, 31997Y1209(01), 52001XC1222(03), 52006XC1208(04) и 52006XC0901(01). Më 11 tetor 2011 hyri në fuqi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 136/11) me të cilin bëhet harmonizimi i mëtutjeshëm i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/2010) i Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/05, 110/08 dhe 51/11), gjegjësisht është bërë një saktësim dhe rregullim i dispozitave për vënien e procedurës për zbatimin e parimit „heshtje domethënë miratim”. Të njëjtat do të kontribuojnë në realizimin më të shpejtë dhe më efikas të të drejtave të qytetarëve gjegjësisht ndërmarrjeve në drejtim të marrjes së një vendimi për të përjashtuar nga detyrimi për suspendimin e përqendrimit i cili është i rregulluar në nenin 18 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Më 04.03.2014 hyri në fuqi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 41/14), me të cilin kryhet preciziteti i procedurës për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe kushteve që kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës duhet ti plotësojnë.

1.2 Aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: LMK)

Me propozim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 23.03.2012 miratoi 9 (nëntë) rregullore që burojnë nga LMK:

1. Rregullorja për kushtet më të afërta për marrëveshjet më rëndësi të vogël („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar masa e UE-së 52001XC1222(03);
2. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e njoftimit të përqendrimit dhe dokumentacioni i kërkuar që parashtrohet së bashku me njoftimin („Gazeta



- Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32004R0802;
3. Rregullorja për përjashtime grupore të llojeve të caktuar të marrëveshjeve për sigurim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0267;
 4. Rregullorja për kushtet më të afërta për përjashtime grupore të llojeve të caktuara të marrëveshjeve horizontale të specializimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R1218;
 5. Rregullorja për kushtet më të afërta për përjashtime grupore të llojeve të caktuara të marrëveshjeve për transferimin e teknologjisë, licencës, ose know-how („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32004R0772;
 6. Rregullorja për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara të marrëveshjeve vertikale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0330;
 7. Rregullorja për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara për distribucion dhe servisim të automjeteve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R0461;
 8. Rregullorja për kushte më të afërta për përjashtime grupore për disa lloje të caktuara për hulumtim dhe zhvillim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar rregullorja e UE-së 32010R1217 dhe
 9. Rregullorja për kushte më të afërta për lirimin ose zvogëlimin e gjobës dhe procedura sipas të cilit Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje vendos për lirimin ose zvogëlimin e gjobës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12). Me këtë rregullore është transponuar masa e UE-së 52006XC1208(04).

Me këto rregullore është arrit një shkallë më e lartë e harmonizimit legjislativ nacional me UE *acquis*.

1.3. udhëzimet, synimet dhe broshurat për zbatimin e legjislativit të konkurrencës

Në vitin 2014, Komisioni hartoi dhe miratoi një Udhëzues për zbulimin e marrëveshjeve të paligjshme gjatë procedurave për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike.



2. Aktivitetet e Komisionit në vitin 2014 në fushën e mbrojtjes së konkurrencës

Aktivitetet themelore që Komisioni kryen në bazë të LMK-së janë:

- udhëheqja e procedurave për përcaktimin e ekzistimit të kundërvajtjeve që janë të përcaktuara në LMK;
- udhëheqja e procedurave administrative për vlerësimin e përqendrimeve;
- analiza e gjendjes në tregjet e caktuara;
- dhënie e mendimit.

2.1 Procedurat administrative dhe kundërvajtëse që kryhen (zhvillohen) nga Komisioni në vitin 2014

LMK vërteton tri forma themelore të veprimtarisë së ndërmarrjes që mund të parandaloj, kufizoj ose prish konkurrencën në treg. Këto janë: marrëveshjet e ndaluara, keqpërdorimi i pozitës dominuese dhe përqendrimet e ndaluara. Prandaj, fushëveprimi i Komisionit, në kuptimin më të ngushtë të fjalës, i përfshinë fushat e mëposhtme:

- vërtetimi i ekzistimit të marrëveshjeve të ndaluara, vendimeve dhe sjelljeve të harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve;
- keqpërdorimi me pozitën dominuese nga ndërmarrjet që zotërojnë një pozitë dominuese dhe
- kontrolli i përqendrimeve të ndërmarrjeve.

Vërtetimi i ekzistimit të marrëveshjeve të ndaluara, vendimeve dhe sjelljeve të harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve dhe ekzistimi i keqpërdorimit me pozitën dominuese nga ndërmarrjet që zotërojnë një pozitë dominuese kryhen në procedurat për kundërvajtje. Procedurat për kundërvajtje që kryhen dhe miratojnë vendime është Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK) i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës që profesionalisht janë të angazhuar në punën e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Konrolli i përqendrimeve të ndërmarrjeve kryhet në procedurat administrative që i udhëheq dhe për të cilat miraton vendim Komisioni.

2.2 marrëveshjet, vendimet dhe sjellja e harmonizuar ndërmjet ndërmarrjeve

Në bazë të LMK, janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve, si dhe çdo sjellje e harmonizuar që prodhon efekt në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe qëllimi i të cilit është parandalimi, kufizimi ose prishja e



konkurrencës. Kjo ndalesë siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi 1 i LMK-së, veçanërisht vlen për ato marrëveshje, vendime apo praktikave kontraktuese qëllimi ose pasoja e të cilit është:

- drejtperdrejt ose terthorazi i fiksojnë cmimet e blerjes ose të shitjes ose disa kushte tjera për tregtim;
- e kufizojne ose e kontrollojne prodhimtarine, tregun, zhvillimin teknik ose investimet;
- e ndajne tregun ose burimet e furnizimit;
- zbatojne kushte të ndryshme për pune juridike të njejta ose të ngjashme me partneret tjere tregtare, me çfare i vene në pozite të pavolitshme konkurruese dhe
- e kushtezojne lidhjen e marreveshjeve me pranim nga palet tjera kontraktuese obligime shtese, që sipas nat-yres së vet ose në pajtim me traditat tregtare nuk lidhen me lenden e marreveshjes.

Nga ana tjetër, marrëveshjet vendimet, respektivisht praktikat kontraktuese që kanë për qëllim ose pasojë parandalimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës, sipas nenit 7 paragrafi (3) të LMK, mund të përjashtohen nga zbatimi i nenit 7 paragrafi (1) i LMK-së, në qoftë se ato kontribuojnë në avancimin e prodhimtarisë ose distribuimin e mallrave ose shërbimeve ose promovimin e zhvillimit teknik ose ekonomik, me kusht që nga ajo të kenë dobi proporcionale edhe konsumatorët, e të cilat nuk u imponojnë ndërmarrjeve përkatëse kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e atyre qëllimeve dhe nuk u mundësojnë atyre ndërmarrjeve eliminim të konkurrencës në vëllim të konsiderueshëm për mallrat ose shërbimet për të cilët bëhet fjalë..

Përveç këtyre përjashtimeve grupe, sistemi maqedonas i mbrojtjes së konkurrencës njih edhe të ashtuquajtura përjashtime grupe për kategori të veçanta të kontratave edhe atë:

- marrëveshjet vertikale;
- marrëveshjet horizontale për hulumtim dhe zhvillim;
- marrëveshjet për transferim të teknologjisë, për licencë ose për know-how;
- marrëveshjet për distribuim ose servisim të automjeteve dhe
- marrëveshjet për sigurim.

Përjashtimet grupe të këtyre kategorive të marrëveshjeve bëhet në bazë të rregulloreve përkatëse të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2012 (shiko pikën 1.2).

Në vitin 2014 KVK miratoi 4 vendime në procedurën e kundërvajtjes në të cilat konstatoi ekzistimin e marrëveshjes së ndaluar edhe atë:

1. Vendim PK nr. 09-2/14 më 31.03.2014 ku në procedure e ngritur sipas detyrës zyrtare kundër Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup dhe Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „ **D-r Panovski” Shkup**, KVK konstatoi se tregtarët me shumicë të sipërpërmendura në mënyrë të harmonizuar janë sjellë gjatë dorëzimit të ofertave për ilaçin me emrin gjenerik injeksione Docetaxel /vijala 20



mg/0,5ml dhe injeksione Docetaxel /vijala 80 mg/2ml në ISHP Klinika Universitare për radioterapi dhe onkologji Shkup edhe atë: në periudhën prej 18.02.2008 deri 20.07.2009 kryerësit Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup i shqiptohet një gjobë në shumë prej 14.954.600,00 denarë ndërsa kryerësit Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „ D-r Panovski” Shkup i shqiptohet një gjobë në shumën prej 6.827.900,00 denarë dhe në periudhën prej 17.06.2010 deri 10.05.2012 kryerësit Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup i shqiptohet një gjobë në shumë prej 11.984.900,00 denarë ndërsa kryerësit Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „ D-r Panovski” Shkup i shqiptohet një gjobë në shumën prej 11.705.200,00 denarë.

2. Vendim PK nr. 09-17/17 më 22.05.2014, ku në procedurën e ngritur sipas detyrës zyrtare kundër Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup dhe Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „ D-r Panovski” Shkup, KVK konstatoi që tregtarët me shumicë të sipërpërmendura në periudhën prej 21.06.2011 deri 05.12.2012 në mënyrë të harmonizuar janë sjellë gjatë dorëzimit të ofertave për ilaçin Etoposide i blerë nga 4 klinikat në Maqedoni në vitin 2011, për të cilin KVK i shqipton një gjobë Alakolid Kons në shumën prej 225.284,00 denarë, ndërsa D-r Panovski 117,280,00 denarë.
3. Vendim PK nr. 09-17/77 më 21.10.2014, ku në procedurën e ngritur sipas detyrës zyrtare kundër Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime EFT Makedonija SHPKNJP- Shkup, Shoqërisë për tregti të energjisë elektrike EZPADA SHPKNJP Shkup, Shoqërisë për tregti të energjisë elektrike RUDNAP SHPKNJP Shkup, Shoqërisë për tregti dhe shitje të energjisë elektrike GEN-I SHPKNJP Shkup dhe GEN-I për tregti dhe shitje të energjisë elektrike sh.p.k., Krshko, SIlloveni, KVK konstatoi se ndërmarrjet e sipërpërmendura kanë marrë pjesë në një marrëveshje të ndaluar- kartel në furnizimin publik. Pikërisht, të njëjtit dorëzuan oferta për shitje të energjisë elektrike me çmime dhe sasi paraprakisht të përcaktuara në një mënyrë që i lejoi ata që të ndajnë sasi të energjisë elektrike të cilin duhet ta porosit SHA ELEM (SHA ELEM merret me furnizimin energjisë elektrike për konsumatorët-amvisëritë tarifor dhe ndërmarrjet të cilët janë të lidhura në sistemin e distribuimit të energjisë elektrike). Në vendimin KVK konstatoi se Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime EFT Makedonija SHPKNJP- Shkup, Shoqëria për tregti dhe shitje të energjisë elektrike GEN-I SHPKNJP Shkup, Shoqëria për tregti të energjisë elektrike EZPADA SHPKNJP Shkup dhe Shoqëria për tregti të energjisë elektrike RUDNAP SHPKNJP Shkup, kanë marrë pjesë në kundërvajtjen në fjalë në periudhën prej 18.10.2011 deri më 29.02.2012, në 11 raste, ndërsa GEN-I për tregti dhe shitje të energjisë elektrike sh.p.k., Krshko, SIlloveni, ka marrë pjesë në kundërvajtje në periudhën prej 28.10.2011 deri më 29.02.2012, në 4 raste. KVK për kundërvajtjen e theksuar u shqiptoi gjobë ndërmarrjeve të përmendura edhe atë:



- Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime EFT Makedonija SHPKNJP- Shkup, i shqiptoi një gjobë prej 121.619.000,00 denarë;
- Shoqërisë për tregti të energjisë elektrike EZPADA SHPKNJP Shkup, i shqiptoi një gjobë prej 89.265,00;
- Shoqërisë për tregti dhe shitje të energjisë elektrike GEN-I SHPKNJP Shkup, për një pjesë të kundërvajtjes i shqiptoi një gjobë prej 30.022.000,00;
- Shoqërisë për tregti dhe shitje të energjisë elektrike GEN-I SHPKNJP Shkup dhe kryerësit GEN-I për tregti dhe shitje të energjisë elektrike sh.p.k., Krshko, Silloveni, shqiptoi një gjobë të përbashkët në shumën prej 28.623.000,00 denarë.

4. Vendim PK nr. 09-2/23 më 06.11.2014, ku në procedurën e ngritur sipas detyrës zyrtare kundër Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup dhe Shoqërisë Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „D-r Panovski”, KVK konstaton që tregtarët me shumicë që i cekëm më lartë në mënyrë të harmonizuar janë sjellë gjatë dorëzimit të ofertave për ilaçin Docatexel të cilin e kanë furnizuar dy klinika në Maqedoninë me an të një tenderi në periudhën prej 18.02.2008 deri më 20.07.2009, ku kryerësit Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup i shqiptohet një gjobë në shumë prej 14.954.600,00 denarë, ndërsa kryerësit Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „D-r Panovski” Shkup i shqiptohet një gjobë në shumën prej 6.827.900,00 denarë, dhe në periudhën prej 17.06.2010 deri më 21.05.2012, kryerësit Alkaloid Kons eksport-import SHKPNJP, Shkup i shqiptohet një gjobë në shumë prej 11.984.900,00 denarë ndërsa kryerësit Shoqëria Aksionare e barnave, pajisjeve mjekësore, qarkullimit dhe shërbimeve „D-r Panovski” Shkup i shqiptohet një gjobë në shumën prej 11.705.200,00 denarë.

2.3 Keqpërdorimi i pozitës dominuese

Në bazë LMK-së ndalohet çdo keqpërdorim i pozitës dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant ose pjesës së tij thelbësore. Në LMK janë dhënë 6 raste të cilët paraqesin keqpërdorim të pozitës dominuese:

- imponim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të cmime-ve të padrejta të blerjes ose të shitjes ose kushteve tjera të padrejta të tregtimit;
- kufizim të prodhimtarisë, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;
- aplikim të kushteve të ndryshme për punë juridike të njëjta ose të ngjashme me partnerë tjerë tregtarë, me çfarë vihen në pozitë të pavolitshme konkurruese;
- kushtëzim të lidhjes së marrëveshjeve me pranim nga palët tjera kontraktuese obligime shtesë, që sipas natyrës së vet ose në pajtim me traditat tregtare, nuk lidhen me lëndën e marrëveshjes;
- refuzimi të tregtohet ose nxitja dhe kërkesa nga ndërmarrjet tjera ose shoqatat e ndërmarrjeve të mos blejnë ose shesin mallra, ose shërbime në ndonjë ndërmarrje të caktuar, me qëllim që në mënyrë të pandershme t'i shkaktohet dëm asaj ndërmarrjeje dhe



- refuzimit të paarsyeshëm që t'i mundësohet qasje në rrjetin personal ose objekte tjera infrastrukturore ndërmarrjes tjetër për kompensim përkatës, nëse pa shfrytëzimin e këtillë të njëkohshëm, ndërmarrja tjetër, për shkaqe juridike ose faktike t'i pamundësohet të veprojë si një konkurrent i ndërmarrjes dominuese.

Në vitin 2014, KVK miratoi 4 vendime në procedurën për kundërvajtje në të cilën konstatoi ekzistimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese edhe atë:

1. Vendim PK nr. 09-3/8 më 31.03.2014, në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare kundër NP Komunalna Higijena- Shkup, KVK konstaton që NP Komunalna Higijena- Shkup ka keqpërdorur pozitën e vet dominuese në tregun e deponimit të mbeturinave komunale nga territori i Qytetit të Shkupit në mënyrë që i refuzohet qasje për deponim një ndërmarrje tjetër (EKO KLUB SHPKNJP) dhe me këtë e ka parandaluar atë të vepron si një konkurrent në tregun përkatës në periudhën prej 31.12.2006 deri më 15.01.2007 dhe për këtë KVK-ja i shqipton një gjobë në shumën prej 12.000,00 denarë dhe në periudhën prej 10.06.2008 deri më 31.12.2009, KVK-ja i shqipton gjobë në shumën prej 596.400,00 denarë.

2. Vendim PK nr. 09-4/9 më 04.04.2014, në procedurën e iniciuar me kërkesë të personit fizik P.D. kundër NPVK Komunalec Gevgelija në të cilin KVK konstaton që NPVK Komunalec Gevgelija ka keqpërdorur pozitën e vet dominuese në treg për ndërtimin, rekonstruktimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Gjevgjelisë si vijon:

- në periudhën prej 22.01.2009 deri në ditën e miratimit të këtij vendimi dhe në mënyrën që gjatë realizimit solidar të varrimit nuk parashikoi mundësinë për refundimin e mjeteve për shfrytëzuesit solidar të varrimit në rast të shfrytëzimit të shërbimeve funerale nga ndërmarrjet tjera të cilat i ofrojnë këto shërbime, paraqet kundërvajtje dhe për këtë KVK e gjobitë në shumë prej 123.000,00 denarë.
- në periudhën prej 27.01.2009 deri në ditën e miratimit të këtij vendimi në mënyrë që lidh shfrytëzimin solidar të varrimit dhe pajisjeve funerale me pagesën e faturave për shërbime komunale që gjithashtu paraqet kundërvajtje, dhe për këtë i shqiptohet një gjobë prej 30.750,00 denarë.

3. Vendim PK nr. 09-28/2 më 15.09.2014 i miratuar në procedurë i cili është iniciuar me kërkesë të një Shoqërie tregtare për prodhimtari, tregti dhe shërbime **Denis Shibakovski SHPKNJP „Miren Son” Ohrid** kundër NPK ohridski komunalec Ohrid në të cilin KVK konstaton që NPK Ohridski komunalec e ka keqpërdorur pozitën e vet dominuese në tregun e ndërtimit, rekonstruktimit, administrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës së Ohrit në periudhën prej 25.05.2010 deri më 04.01.2011 duke imponuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kushte të padrejta të tregtimit në një mënyrë që gjatë nënshkrimit të një marrëveshje për qasje dhe shfrytëzim të infrastrukturës së varrezave të Qytetit në Ohër me të cilët



administron, NPK Ohridski komunalac Ohrid në mënyrë të pajustificuar ju imponon operatoreve të shërbimeve funerale pagesën e një shume shtesë prej 10.000,00 den në muaj në emër të mirëmbajtjes së higjienës dhe pastrimin publik të të gjithë infrastrukturës që operatori i shërbimeve funerale e përdor gjatë kryerjes së një varrimi, dhe për këtë KVK kryerësit i shqipton një gjobë në shumën prej 120.000,00 denarë.

4. Vendimi PK 09-13/9 më 24.12.2014 në procedurën e iniciuar me kërkesë të personit fizik A.T. kundër NPK KOMUNALEC Prilep në të cilin KVK konstaton që NPK KOMUNALEC Prilep ka keqpërdorur pozitën e vet dominuese në tregun e ndërtimit, rekonstruktimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në territorin e komunës së Prilepit:

- në periudhën prej në periudhën prej 13.11.2010 deri në ditën e miratimit të këtij vendimi dhe në mënyrën që gjatë realizimit solidar të varrimit nuk parashikoi mundësinë për refundimin e mjeteve për shfrytëzuesit solidar të varrimit në rast të shfrytëzimit të shërbimeve funerale nga ndërmarrjet tjera të cilat i ofrojnë këto shërbime, dhe për këtë KVK NPK KOMUNALEC Prilep e gjobitë në shumë prej 481.000,00 denarë dhe

- në periudhën prej 13.11.2010 deri më 01.09.2012 në mënyrë që lidh shfrytëzimin solidar të varrimit me pagesën e faturave për shërbime komunale, respektivisht kushtëzoi shfrytëzimin e mjeteve nga kompensimi solidar për varrim dhe pajisje funerale duke pranuar detyrime shtesë- pagesën për ujë dhe mbeturina, veprimet e të cilëve për nga natyra e tyre nuk janë të lidhura me lëndën e kontratës, për të cilin KVK NPK KOMUNALEC Prilep i shqipton një gjobë në shumë prej 140.000,00 denarë.

2.4. shkeljet e rënda në procedurë për vlerësimin e përqendrimeve

Në vitin 2014, KVK miratoi 2 vendime në procedurën për kundërvajtje për shkak të mosdorëzimit të njoftimit të përqendrimit si vijon:

1. Vendim PK nr. 09-11/9 më 07.05.2014, më të cilin KVK konstaton që
- UML- United Media LTD (me emrin e mëparshëm: Adria Media Limited) Qipro, si një ndërmarrje e cila ka fituar kontrollin mbi IKO Balkan S.R.L. edhe pse në bazë të nenit 15 të LMK-së ishte e detyruar deri në komision të dorëzojë njoftim për përqendrim para se të zbatohet respektivisht para parashtrimit të fletëparaqitjes për ndryshim në regjistrin përkatës, dhe pas nënshkrimit të kontratës, i njëjti nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim, me çka ka bërë shkeje në bazë të nenit 60 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së dhe për këtë i shqiptohet një sanksion-gjobë prej 307.500,00 denarë dhe që

- UML- United Media LTD (me emrin e mëparshëm: Adria Media Limited) Qipro, si një ndërmarrje e cila ka fituar kontrollin mbi IKO Balkan S.R.L ka zbatuar përqendrimin para se të parashtrroj njoftim për këtë në Komision duke shkelur kështu nenin 18 paragrafin (1) të LMK-së e cila paraqet një shkelje të nenit 60 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së, dhe në bazë të kësaj i shqiptohet një gjobë prej 615.000,00 denarë.

2. Vendim PK nr. 09-12/11 më 07.05.2014- me të cilin KVK konstaton që



- Slovenia Brodbend S.a.r.l. Luksemburg si një ndërmarrje e cika ka fituar kontrollin mbi Solford Trejding Limited edhe pse në bazë të nenit 15 të LMK-së ishte e detyruar deri në komision të dorëzojë njoftim për përqendrim para se të zbatohet respektivisht para parashtrimit të fletëparaqitjes për ndryshim në regjistrin përkatës, dhe pas nënshkrimit të kontratës, i njëjti nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim, me çka ka bërë shkelje në bazë të nenit 60 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së dhe për këtë i shqiptohet një sanksion-gjobë prej 307.500,00 denarë dhe që

- Slovenia Brodbend S.a.r.l. Luksemburg si një ndërmarrje e cika ka fituar kontrollin mbi Solford Trejding Limited edhe pse në bazë të nenit 18 paragrafi (1) të LMK-së nuk duhet ta zbatonte përqendrimin para se të parashtrohej njoftim për të njëjtën, Slovenia Brodbend S.a.r.l. Luksemburg, ka zbatuar përqendrimin duke parashtruar njoftim për ndryshim në regjistrin përkatës, dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 60 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së, dhe në bazë të kësaj i shqiptohet një gjobë prej 123.000,00 denarë.

2.5. Vlerësimi i përqendrimeve të ndërmarrjeve

Kapitulli i tretë i LMK-së i referohet kontrollit të përqendrimeve.

Në bazë të LMK-së pjesëmarrësit në përqendrim (në tekstin e mëtejme: pjesëmarrësit) janë të obliguar ta njoftojnë Komisionin në qoftë se ndodh ndryshim në kontrollin në bazë afat-gjatë dhe në qoftë se:

1. Të ardhurat e përbashkëta dhe të përgjithshme vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse që u realizuan me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun botërorë, e tejkalon shumën prej 10 milion euro në kundërvlerë të denarit, bazuar në kursin valutor në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, që u realizua gjatë vitit afarist para zbatimit të përqendrimit, ku të paktën njëri prej pjesëmarrësve duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

2. të ardhurat e përbashkëta dhe të përgjithshme vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse që u realizuan me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në Republikën e Maqedonisë, e tejkalon shumën prej 2,5 milion euro në kundërvlerë të denarit, bazuar në kursin valutor në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, që u realizua gjatë vitit afarist para zbatimit të përqendrimit ose

3. pjesëmarrja në treg e njërit prej pjesëmarrësve është më shumë se 40% ose pjesëmarrja e përgjithshme e pjesëmarrësve në treg është më shumë se 60% në vitin para zbatimit të përqendrimit.

Komisioni vlerëson përqendrimet e paraqitura dhe miraton një vendim duke konstatuar që përqendrimi i paraqitur është në përputhje ose jo me LMK-në.

Në vitin 2014, në Komision u parashtruan 29 njoftime për përqendrim. Në vitin 2014, Komisioni miratoi 30 vendime.



Procedurat në lidhje me njoftimet e parashtruara të përqendrimeve

Numri i njoftimeve të parashtruara	29
Vendimet e miratuara-gjithsej	30
- Përqendrimet e miratuara (është në përputhje me Ligjin)	29
- Përqendrimet e miratuara me kusht	/
- Përqendrimet e ndaluara (nuk është në përputhje me Ligjin)	/
- Përqendrimi nuk bie nën dispozitat e Ligjit	1

Në 29 vendime është konstatuar që përqendrimi edhe pse bie nën dispozitat e LMK-së, ajo nuk do të ketë si pasojë të konsiderueshme parandalimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg, ose një pjesë esenciale të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose përforsimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e LMK-së, si vijon:

1. Vendim Pa. nr. 08-144 më 09.01.2014 për përqendrim ndërmjet Adria Media Limited (Adria Media Limited), Qipro dhe IKO Balkan S.R.L. (IKO Balkan S.R.L.) Bukuresht, Romani, në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e prodhimit dhe shpërndarjes së kanaleve televizive.
2. Vendim Pa. nr. 08-145 më 09.01.2014 për përqendrim ndërmjet Slovenia Brodbend S.a.r.l. (Slovenia Broadband S.a.r.l.) Luksemburg dhe Solford Trejding Limited (Solford Trading Limited), Qipro, në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e Net TV Plus platforma programore dhe IP Televizioni.
3. Vendim Pa. nr. 08-148 më 09.01.2014 për përqendrim ndërmjet Remho Betailigungs GmbH (Remho Beteiligungs GmbH), Vjenë, Austri (AlserbachstraBe 14-16 Palais Liechtenstein, 1090 Wien, Austria) dhe Helios sestavljeno podjetje za kapitalske nalozhbe in razvoj, d.d. (HELIOS sestavljeno podjetje za kapitalske nalozhbe in razvoj, d.d.), Republika e Sllovenisë (Kolicovo 2, 1230 Domzale, Slovenija), në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e prodhimit dhe shitjen e ngjyrave.
4. Vendim Pa. nr. 08-149 më 09.01.2014 për përqendrim ndërmjet personit K.G., shtetas i Republikës së Bullgarisë dhe Direct Media shpk Beograd Serbi. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shërbimeve të marketingut.
5. Vendim Pa. nr. 08-150 më 31.01.2014 për përqendrim ndërmjet SAGS shpk Beograd (SAGA doo Beograd) Novi Sad Serbi, në bazë të blerjes së pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e It zgjidhjeve dhe IT shërbimeve.
6. Vendim Pa. nr. 08-152 më 06.03.2014 për përqendrim ndërmjet Shoqërisë tregtare Adris grupa d.d., Rovinj, Republika e Kroacisë dhe Kroacija Osiguruvanje d.d., Zagreb, Republika e Kroacisë, në bazë të blerjes së pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e shërbimeve të sigurimit.
7. Vendim Pa. nr. 08-153 më 06.03.2014 për përqendrim ndërmjet Dojçe Telekom AG ((Deutsche Telekom AG), Bon, Republika Federale e Gjermanisë dhe Konzorcium 1 S.a.r.l. (Consortium 1 S.a.r.l), Luksemburg në bazë të blerjes së



pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e shërbimeve të telekomunikacionit.

8. Vendim Pa. nr. 08-154 më 06.03.2014 për përqendrim ndërmjet Overseas Transport Holding GMBH (Overseas Transport Holding GmbH) Lauterah, Austri dhe Veiss-Rohlig Kina Limited (Weiss-Rohlig China), Hong Kong, Koulun, Kina, Veiss-Rohlig Tajvan Ltd (Weiss-Rohlig Taiwan Ltd) Tajpej, Tajvan, Veiss-Rohlig Lindja e mesme Ltd (Weiss-Rohlig Middle East Ltd) Dubai, OAE, Veiss-Rohlig Holding GmbH (Weiss-Rohlig Holding GmbH) Lauterah, Austri, Veiss-Rohlig Kanada Ink. (Weiss-Rohlig Canada Inc.) Toronto, Kanada, në bazë të blerjes së pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e shërbimeve të karrocierit në fushën e aviacionit ndërkombëtar dhe transportin detar.

9. Vendim Pa. nr. 08-156 më 24.03.2014 për përqendrim ndërmjet Kuhengerger Evropa Lindore GmbH, Austri dhe shoqëria për transport ndërkombëtar dhe të mallrave Logvin Solushns Makedonija SHPKNJP, Shtip, Maqedoni në bazë të blerjes së pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e transportit të mallrave.

10. Vendim Pa. nr. 08-158 më 24.03.2014 për përqendrim sipas të cilit Fater S.p.A, Itali fiton mjetet për prodhimtari, paketim, distribuim, marketing dhe shitjen **e mjeteve për mjekim nën markën tregtare “Ace”, mjetet e të cilëve janë nën kontrollin e Prokter dhe Gembel Grupit në krye me Prokter dhe Gembel Kompani, me seli në Prokter dhe Gembel Plaza 1, Sinsinati, Ohajo, SHBA.** Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e aditivëve për larjen e rrobave.

11. Vendim Pa. nr. 08-160 më 24.03.2014 për përqendrim sipas të cilit Pamplona Kapital Partners III L.P. Pamplona Capital Partners III, L.P.), Ishujt Kajman, nëpërmjet shoqërisë së lidhur të saj PHM Topko 21 S.a.r.l. (PHM Topco 21 S.a.r.l.), Luksemburg do të fiton kontrollin mbi Alvogen Luks Holdings S.a.r.l. (Alvogen Lux Holdings S.a.r.l.), Luksemburg në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e prodhimit dhe shitjes së produkteve farmaceutike.

12. Vendim PA. nr. 08-161 më 10.04.2014 për përqendrim ndërmjet Visteon Korporejshn (Visteon Corporation), qyteti Vilmington, qarku Nju Kasl, Shteti Federal Delaver, SHBA dhe XHONSON KONTROLS MAKEDONIA SHPKNJP Shkup (JOHNSON CONTROLS MACEDONIA DOOEL Skopje) Ilinden, Shkup, Maqedoni, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun për prodhimin dhe furnizimin e instrument tablove në industrinë e automobilave;

13. Vendim PA. nr. 08-162 më 10.04.2014 për përqendrim ndërmjet NOVA LUBLANSKA BANKA dd Lubjanë (NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d. Ljubljana), Lubjanë Slloveni, SID- Banka Sllovene për eksport dhe zhvillim dd Lublana (SID – Slovenska izvozna in razvojna banka d.d. Ljubljana), Lubjanë Slloveni, dhe FIM Banka p.l.c. (FIMBank p.l.c.), Malta në njërin anë dhe PRVI FAKTOR d.o.o Lubjanë, Slloveni nga ana tjetër në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e shërbimeve bankare;

14. Vendim PA. nr. 08-165 më 14.05.2014 për përqendrim ndërmjet Eurostandard Banka SHA Shkup, Shkup, Maqedoni, dhe Poshtenska Banka SHA Shkup, Shkup, Maqedoni, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e shërbimeve bankare;

15. Vendim PA. nr. 08-167 më 15.05.2014 për përqendrim ndërmjet Karso Telekom B.V. (Carso Telekom B.V.) Amsterdam, Holland (Prins Bernhardplein 200,



1097 JB Amsterdam, the Netherlands) dhe Telekom Avstrija Aktiengesellschaft Telekom Austria Aktiengesellschaft) Vjenë, Austri (Lassallestrasse 9, 1020 Vienna, Austria), në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e telekomunikacionit.

16. Vendim PA. nr. 08-166 më 22.05.2014 për përqendrim ndërmjet personit F.S. Shkup, Maqedoni dhe Shoqëria tregtare për përfaqsim, shërbime dhe tregti me shumicë dhe pakicë AKCENT MEDIA Agjencia Nazionale për Reklamë o.o. SHPKNJP eksport-import Shkup, Shkup, Maqedoni. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në treg për reklamat në media;

17. Vendim PA. nr. 08-170 më 30.05.2014 për përqendrim ndërmjet Junajted Media S.a.r.l. (United Media S.a.r.l.) Principata e Madhe Luksemburg , Grand Slam Grup d.o.o. (Grand Slam Group d.o.o.) Beograd, Serbi dhe personi A.P. nga Serbia në njëjërën anë dhe Grand Prodakshn d.o.o. (Grand Production d.o.o.) Beograd, Serbi nga ana tjetër, në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në regjistrimin e zërit dhe shtëpinë muzikore,

18. Vendim PA. nr. 08-171 më 30.05.2014 për përqendrim ndërmjet Filip Moris Internacional Menaxhment SA (Philip Morris International Management SA) Lozan, Zvicër dhe Tutunski kombinat SHA Prilep, Maqedoni, në bazë të investimeve të përbashkëta. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun për prodhimin dhe furnizimin e produkteve të duhanit/cigareve;

19. Vendim PA. nr. 08-172 më 03.07.2014 për përqendrim ndërmjet KAS-One Holdinggezelshaft mbH (CAS-One Holdinggesellschaft mbH) Hanover dhe Emitek Gezelshaft Fur Emisiontehnologi mbH (Emitec Gesellschaft für Emissionstechnologie mbH) Lohmar, Gjermani, në bazë të fitimit të pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e prodhimit të produkteve për trajtimin e gazeve të zbratura për qëllime të ndryshme, duke përfshirë automjetet, makineritë stacionare dhe të lëvizshme, termocentralet, lokomotivat dhe anijet;

20. Vendim PA. nr. 08-173 më 03.07.2014 për përqendrim ndërmjet Slovenia Broadband S.a.r.l. Luksemburg (Slovenia Broadband S.a.r.l. Luxembourg) Luksemburg, Principata e Madhe Luksemburg dhe SHA Broadband Montenegro (AD Broadband Montenegro) Podgoricë, Mali zi, në bazë të shitblerjes në aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacioneve;

21. Vendim PA. nr. 08-174 më 24.07.2014 për përqendrim ndërmjet mobilkom Macedonien Betajligungsfervaltung GmbH (*mobilkom Mazedonien Beteiligungsverwaltung GmbH*) Vjenë, Austri dhe Blizu Media dhe Brodband SHPKNJP Shkup, Shkup Maqedoni, në batë të shitjes së pjesëve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacioneve;

22. Vendim PA. nr. 08-175 më 08.08.2014 për përqendrim ndërmjet Principata e Lihtenshtajnit (Principality of Liechtenstein) dhe Mobilkom Beteiligungsgezelshaft mbH (Mobilkom Beteiligungsgesellschaft mbH) Vjenë, austri në njëjërën anë dhe Telekom Lihtenshtajn AG (Telecom Liechtenstein AG), Lihtenshtajn nga ana tjetër, bazuar në blerjen e kontrollit të përbashkët. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e telekomunikacioneve;



23. Vendim PA. nr. 08-177 më 08.08.2014 për përqendrim me të cilin Hemofarm a.d. Vrshac (Hemofarm a.d. Vrsac), Vrshac, Republika e Serbisë, fiton mjetet për prodhimin dhe shitjen e produkteve të caktuara farmaceutiken në pronësi të Farmanova SHPK Obrenovac (Pharmanova d.o.o. Obrenovac) Beograd, Republika e Serbisë, në bazë të fitimit të kontrollit nëpërmjet blerjes së mjeteve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktive në tregun për prodhimin dhe shitjen e produkteve farmaceutike;
24. Vendim PA. nr. 08-178 më 08.08.2014 për përqendrim ndërmjet Alfa Banka A.E (Alpha Bank A.E) Athinë, Republika e Greqisë, nga njëra anë dhe SitiBanka internacional PLC (CitiBank International PLC), London Mbretëria e Bashkuar dhe Diners Klub e Greqisë kompania financiare S.A. (Diners Club of Greece Finance Company S.A) Athinë, Republika e Greqisë, nga ana tjetër, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në tregun e shërbimeve bankare,
25. Vendim PA. nr. 08-179 më 08.08.2014 për përqendrim ndërmjet Arçer Daniels Midland Jurop B.V. (Archer Daniels Midland Europe B.V.) Holandë, Arçer Daniels Midland Europort B.V. (Archer Daniels Midland Europort B.V) Holandë dhe ADM Germanija GmbH (ADM Germany GmbH) Hamburg , Gjermani nga njëra anë dhe VILD Flejvors GmbH (WILD Flavors GmbH), Zvicër dhe VILD Deri Ingridients GmbH (WILD Dairy Ingredients GmbH), Gjermani nga ana tjetër, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e sistemeve për shije;
26. Vendim PA. nr. 08-180 më 05.09.2014 për përqendrim ndërmjet Junajted Media S.a.r.l. (United Media S.a.r.l.) Luksemburg, Mbretëria e Bashkuar Luksemburg dhe Orlando Klinci SHPK (Orlando Klinci d.o.o.) Zagreb, Republika e Kroacisë, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e telekomunikacioneve;
27. Vendim PA. nr. 08-182 më 25.11.2014 për përqendrim ndërmjet Telemax Shoqëria për ofrimin e shërbimeve në fushën e telekomunikacionit SHPK Saraevo Ilixha-Saraevo, Bosnje dhe Hercegovinë dhe BHB KEJBL TV SHPK Lukavac, Lukavac, Bosnje dhe Hercegovinë, në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e telekomunikacioneve;
28. Vendim PA. nr. 08-183 më 25.11.2014 për përqendrim ndërmjet Telemah për komunikim të gjerë SHPK, Lubjanë, Slloveni dhe Tushmobil SHPK Shoqëria për komunikim celular, Lubjanë-Crnuçe , Slloveni, në bazë të shitblerjes së aksioneve. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktiv në tregun e telekomunikacioneve;
29. Vendim PA. nr. 08-185 më 24.12.2014 për përqendrim ndërmjet Shoqërisë për inxhinieri të telekomunikacionit, softuerit, tregtisë dhe shërbimeve BLIZU MEDIA END BROUDBEND SHPKNJP Shkup në njërin anë, dhe Shoqëria tregtare për radiodifuzion - operator i rrjetit kabllor ASTRA PLUS SHPK, Koçan , Shoqëri tregtare për punësimin e personave me invaliditet-shoqëri e mbrojtur, shoqëri për radiodifuzion- operator i rrjeti kabllor FILADELFIJA 2002 SHPK, Koçan, Shoqëria tregtare për radiodifuzion - operator i rrjetit kabllor KABEL RIZ SHPK, Koçan, shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime SISTEM KABEL SHPKNJP eksport-import, s. Miladinovci, Ilinden dhe Shoqëria për shërbime dhe tregti SPEJS TEL NET SHPKNJP s. Kadino, s. Kadino Ilinden nga ana tjetër, të gjithë nga Maqedonia, në bazë të fitimit të kontrollit. Pjesëmarrësit në përqendrim janë aktivë në treg për ofrimin e shërbimeve për transmetimin e përmbajtjeve audio-vizuale deri te



shfrytëzuesit përfundimtar dhe tregu për ofrimin e shërbimeve për qasje fikse në internet me një vëllim më të gjërë.

Në vendimin 1 Komisioni konstaton se përqendrimi nuk bie nën dispozitat e LMK-së:

1. Vendim Pa. nr. 08-176 më 05.09.2014 me të cilin Komisioni konstaton që përqendrimi ndërmjet personit fizik A.B. nga Shkupi, Maqedoni dhe MM Investment SHPK Shkup, Maqedoni, në bazë të shitblerjes së aksioneve nuk bie nën dispozitat e LMK-së.

2.6 Bashkëpunimi i Komisionit me trupat rregullator dhe organet tjera shtetërore

Sipas LMK-së, Komisioni gjatë zbatimit të detyrave që janë në kompetencë të tij, bashkëpunon me organet e tjera shtetërore për çështjet që kanë të bëjnë me Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Komisioni dhe trupat rregullator janë të detyruar të shkëmbejnë të dhëna dhe informacione që ato kanë nevojë për ty kryer detyrat që janë në kompetencë të tij, ku vëllimi i shkëmbimit të informacionit është i kufizuar me të dhënat dhe informacionet të cilat janë përkatëse dhe proporcionale me qëllimet e shkëmbimit.

Në vitin 2014, Komisioni vazhdoi bashkëpunimin e suksesshëm me: Komisionin Rregullator për Energjetikë, Agjencinë për komunikime elektronike, Byronë për furnizime publike dhe Këshillin për radiodifuzion (tani Agjencia për shërbime mediale audio dhe audiovizuale). Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet kontakteve të rregullta në kuadër të këshillave për bashkëpunim që janë parashikuara me memorandumet për bashkëpunim dhe përmes bashkëpunimit të ngushtë për lëndët të cilët janë në rrjedhë dhe që janë në kompetencë të komisionit, gjegjësisht Trupave rregullator, të cilët kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme për zhvillim e konkurrencës në sektorët përkatës rregullator.

Më 25.03.2014, Komisioni dhe Agjencia për rregullimin e sektorit hekurudhor, kanë nënshkruar një memorandum për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së konkurrencës në sektorin e hekurudhave.

2.7 Mendimet e dhëna nga Komisioni

Komisioni , në pajtim me LMK-në, jep mendime për projektligjet dhe aktet tjera me të cilin rregullohen çështjet që lidhen me aktivitetin ekonomik, dhe të cilët mund të kenë ndikim në konkurrencën e tregut. Në drejtim të realizimit të këtij autorizimi si dhe në përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet resorëve me organet kompetente në RM, Komisioni paraqiti mendimin e tij nëpërmjet:

- Draft Dokumenti për analizën e parë të tregut relevant 13- transmetim i përmbajtjeve radiodifuzive deri të përdoruesit përfundimtar i cili është i përgatitur nga Agjencia për komunikime elektronike;

- Draft dokumenti për analizën e tregut 1- Qasje në rrjetin e komunikimeve elektronike publike në një lokacion fiks për shfrytëzuesit rezidencial dhe të biznesit, të përgatitura nga Agjencia për komunikime elektronike (korrik 2014);



- Draft dokumenti për analizën e tretë të Tregun 9- segmente terminale e linjave me qira dhe Tregu 10- segmente transmetuese e linjave me qira (gusht 2014);
- Draft dokumenti për analizën e Tregun 9- shërbime telefonike në dispozicion për publikun në një lokacion fiks për shfrytëzuesit rezidencial dhe të biznesit (shkurt 2015).

Komisioni në vitin 2014 në mënyrë permanente ka bashkëpunuar me Komisionin Rregullator për Energjetikë në Republikën e Maqedonisë në pjesën e përpilimit të akteve nënligjore sipas ligjit për Energjetikë.

3. TRANSPARENCA

Në mënyrë që të siguroj transparencë në punën e tij, Komisioni të gjitha vendimet e tija të plotfuqishme i publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e Komisionit. Ueb faqja e Komisionit në mënyrë të rregullt azhurnohet.

Komisioni ndërmeret aktivitetet me të cilat rrit ndërgjegjshmërinë për nevojën e mbrojtjes së Konkurrencës, duke marrë pjesë në konferenca nacionale, tryeza të rumbullakëta, në informimin e medieve për punën e tij etj

B. NDIHMA SHTETËRORE

4. Korniza juridike

Kornizën juridike në kontrollin e ndihmës shtetërore e përbën Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe aktet nënligjore të cilat janë të nevojshme në zbatimin e saj

4.1 Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Më 28 tetor 2010, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi një Ligj të ri për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10). Ligji hyri në fuqi më 13.11.2010.

Me miratimin e ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore u bë harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit të Maqedonisë në këtë fushë me legjislacionin e UE-së, duke përfshirë: nenet 107-109 të Marrëveshjes së funksionimit të UE-së dhe Rregulloret e UE-së 32001R0069 dhe 31999R0659. Në të njëjtën kohë është rritur ligjshmëria dhe efikasiteti i veprimeve të Komisionit nëpërmjet harmonizimit të dispozitave të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo mundëson një procedurë më të thjeshtë administrative para Komisionit, në çështjet që lidhen me ndihmën shtetërore, procedura e cila do të jetë më e qartë dhe më transparente për të gjitha palët e interesuara.

4.2 Aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Përveç miratimit të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 141/11) dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e parashtrimit të njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore dhe procedura për mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore ekzistuese



(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 142/11), në vitin 2013 u miratua Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 109/13), si dhe Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale (në seancën e Qeverisë e mbajtur më 30.12.2013 dhe e njëjta është publikuar në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 03/14).

Me miratimin e Rregullores për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale rregullohen në mënyrë të detajuar kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale. Njëkohësisht, rregullohen çështjet që kanë një rëndësi të veçantë për vlerësimin efektiv mbi ndarjen e planifikuar të ndihmës regjionale, si dhe për kushtet dhe procedurën për ndarjen e të njëjtës në Republikën Maqedonisë nga ana e Komisionit. E njëjta është në harmonizim me legjislacionin evropian në fushën e ndarjes së ndihmës regjionale. Me këtë Rregullore precizohen kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale, e cila është e rëndësishme për vlerësimin e drejtë dhe në kohë të lejueshmërisë ose pa lejueshmërisë për ndarjen e të njëjtës, dhe në këtë mënyrë do të mundësohet një zbatim efikas i kompetencave të Komisionit gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të ndarjes së ndihmës regjionale shtetërore. Miratimi i Rregullores është bërë me qëllim të harmonizimit të kushteve dhe procedurës për ndarjen e ndihmës regjionale me kërkesat e UE *acquis*.

Komisioni vazhdon me harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit evropian me miratimin e Rregullores për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës horizontale. Me këtë Rregullore rregullohen çështjet që kanë një rëndësi të veçantë për vlerësimin efektiv të ndarjes së planifikuar të ndihmës horizontale, si dhe për kushtet dhe procedurën për ndarjen e të njëjtës në Republikën e Maqedonisë nga ana e Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës shtetërore në fushat e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit, mbrojtjen e ambientit jetësor, punësimit, trajnimit, ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në çfarëdo forme, duke përfshirë edhe formën e kapitalit të rrezikut, e cila është me rëndësi në vlerësimin e drejtë dhe në kohë të dhënies leje ose jo të ndarjes së ndihmës në këto fusha. Në këtë mënyrë arrihet një shkallë më e lartë e harmonizimit të legjislacionit të Maqedonisë me UE *acquis* në fushën e ndihmës shtetërore. Miratimi i Rregullores është bërë me qëllim të harmonizimit të kushteve dhe procedurës për ndarjen e ndihmës regjionale me kërkesat e UE *acquis*.

Me miratimin e këtyre rregulloreve nuk vlen më Rregullorja për kushtet dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e republikës së Maqedonisë” nr. 157/7) dhe Rregullorja për përcaktimin e kushteve dhe procedura për ndarjen e ndihmës regjionale („Gazeta Zyrtare e republikës së Maqedonisë” nr. 81/03 dhe 118/09).

5. Parimet metodologjike

5.1. Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore

Baza metodologjike e ndihmës shtetërore është vendosur me ligjin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/03, 70/06, dhe 55/07) dhe akteve nënligjore, dhe është plotësuar edhe me Ligjin për Kontrollin e Ndhmës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10).



Gjatë analizës dhe vlerësimit të të dhënave të paraqitura në rastet e mundshme të ndihmës shtetërore, Komisioni edhe më tutje i merr parasysh kriteret themelore të cilët e definojnë ndihmën shtetërore edhe atë nëse:

- bëhet fjalë për masat të cilët përfshijnë transferim të mjeteve shtetërore (duke përfshirë ato nacionale dhe lokale),
- ndihma e dhënë paraqet përparësi ekonomike për marrësin e ndihmës,
- ndihma e dhënë është selektive dhe
- ndihma ka një ndikim në konkurrencë dhe në tregti.

Sipas nenin 6 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), dhënës i ndihmës shtetërore është Qeveria e Republikës së Maqedonisë, organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe çdo organ apo person juridik tjetër, të cilat ndajnë ose planifikojnë të ndajnë ndihmën shtetërore.

Në përcaktimin e instrumenteve financiare janë marrë parasysh grupet e mëposhtme:

- Instrumentet në grupin A, të cilët ndahen në dy nëngrupe, ku në nëngrupin A1, përfshihen mjetet e pakthyeshme në formën e dotacionit, subvencioneve me kamata, shlyerjet e borxheve të ndërmarrjeve të biznesit nga kreditë, pagimi për shlyerje të detyrueshme të borxhit, ndërsa në nëngrupet A2, hyn lehtësimi dhe lirimi nga pagesa e taksave dhe kontributeve të sigurimit social;
- Instrumentet në grupin B, në të cilin përfshihen transferimet financiare të shtetit në formë të investimeve kapitale. Në këtë grup përveç investimeve kapitale klasike, përfshihen edhe konvertimet e kërkesave të pjesëmarrjes në kapital dhe shitjen e volitshme të pronës shtetërore;
- Instrumentet në grupin C, në të cilin përfshihen të gjitha transferimet në të cilin elementi i ndihmës shtetërore paraqet një përfitim të interesit. Këtë transfero janë ose huazime të volitshme (grupi C1) ose pagesë e shtyrë e tatimeve me interes më të ulët (grupi C2);
- Instrumentet në grupin D, në të cilin përfshihen garancitë si një sigurim që vinë nga rreziku komercial ose jo komercial.

6. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës edhe në vitin 2014, vazhdon me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, sidomos me obligimin që rrjedh nga neni 13 i Ligjit në të cilin parashihen të gjitha dhënësit e ndihmës shtetërore (Qeveria e Republikës së Maqedonisë, organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe çdo organ apo person juridik tjetër, të cilat ndajnë ose planifikojnë të ndajnë ndihmën shtetërore) deri te Komisioni të paraqesin njoftim për çdo plan të ndarjes së re ose ndryshim të ndihmës ekzistuese shtetërore, si dhe për ndalesën që ndihma e planifikuar shtetërore ti ndahet shfrytëzuesit në periudhën derisa Komisioni nuk ka miratuar një vendim të tij ose derisa të skadojë afati, në të cilin Komisioni duhet të miratojë një vendim për vlerësimin e ndihmës. Po ashtu, Komisioni u tregonte të



gjithë dhënësve të ndihmës shtetërore për detyrimin që buron nga neni 24 i Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore sipas të cilit çdo dhënës i ndihmës shtetërore është i detyruar që më së voni deri më 31 mars të vitit vijues, ti dorëzoj Komisionit një raport vjetor për ndihmën e lejuar të ndarë shtetërore për vitin paraprak dhe për detyrimin e të njëjtit nen, për çdo dhënës dhe shfrytëzues të ndihmës shtetërore të mbajë evidencë të saktë për ndihmën e ndarë gjegjësisht për ndihmën e marrë shtetërore, si dhe për ndihmën e ndarë gjegjësisht ndihmën e marrë me rëndësi të vogël (de minimis).

6.1 Vendimet/Aktvendimet e miratuar për ndihmën e ndarë shtetërore në vitin 2014

Në vitin 2014, numri i vendimeve të miratuara nga Komisioni është 11, ku në gjashtë vendime u konstatua se masat e përfshira në njoftimet të dorëzuara në Komision nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore paraqesin ndihmë shtetërore në bazë të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), ndërsa te 5 vendimet e tjera, Komisioni konstatoi se masat e përfshirë në njoftim paraqesin ndihmë me rëndësi të vogël (ndihmë de minimis) respektivisht ndihmë të ndarë e cila për një përdorues nuk kalon 200.000 euro për një periudhë prej tre vitesh.

2014

	Numri i Vendimit	Dhënësi	Qëllimi	Shuma në denarë	Shuma në Euro
1	Vendim nr. 10-56 më 31.01.2014 (de minimis)	Ministria e Ekonomisë	Propozim –Programi për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrje në vitin 2014, Zona A. Përkrahja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe mesme	5.690.000,00	92.520
2	Vendim nr. 10-57 më 31.01.2014 (de minimis)	Ministria e Ekonomisë	Propozim –Programi për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrje në vitin 2014, Zona B. Implementimi i politikës industriale	1.700.000,00	27.642
3	Vendim nr 10-58 më 31.01.2014 (de minimis)	Ministria e Ekonomisë	Propozim –Programi për konkurrencë, inovacion dhe sipërmarrje në vitin 2014, Zona B. Përkrahja dhe zhvillimi i grupimit kllasterik	1.600.000,00	26.016
4	Vendim nr 10-151 më 31.01.2014	Qeveria e Republikës së Maqedonisë-	Ndarje e ndihmës së planifikuar shtetërore për zhvillimin regional të Istem		



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS



Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk

		Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit të Rm-së	Medikal SHPK Ilinden ³		
5	Vendim nr.10-155 më 24.03.2014 (de minimis)	Ministria e Ekonomisë	Programi për zhvillimin e turizmit për vitin 2014	800.000,00	13.008
6	Vendim nr.10-157 më 06.03.2014	Qeveria e RM-së- Ministri pa portofol i ngarkuar për investime të huaj Vele Samak	Ndarja e ndihmës së planifikuar shtetërore zhvillim regjional të Anthura MK SHPKNJP import-eksport Shkup		
7	Vendim nr.10-164 më 28.03.2014 (de minimis)	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Plani operativ programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2014	279.487.000,00	4.544.504,00
8	Vendim nr.10-168 më 30.05.2014	Agjencia për promovimin dhe përkrahjen e turizmit	Programi për promovimin dhe përkrahjen e turizmit në vitin 2014 për subvencionimin e qarkullimit të huaj turistik të organizuar në bazë të Rregullores për mënyrën, llojin dhe shumën e subvencioneve	155.000.000,00	2.520.325,00
9	Vendim nr.10-188 më 23.12.2014	Qeveria e RM-së- Ministri pa portofol i ngarkuar për investime të huaj Xheri Naumov	Ndarja e ndihmës së planifikuar shtetërore zhvillim regjional të Startek Makedonija SHPKNJP Shkup		
10	Vendim nr.10-187 më 24.12.2014	Qeveria e RM-së- Ministri pa portofol Visar Fida	Ndarja e ndihmës së planifikuar shtetërore zhvillim regjional të Endava SHPKNJP Shkup		
11	Vendim nr.10-190 më 24.12.2014	Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinor	Programi për investimin në mjedisin jetësorë për vitin 2015	4.000.000,00	65.040
	Вкупно			448.277.000,00	7.289.055,00

³ Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, të dhënat të cilët janë sekret afarist nuk publikohen.



Të dhënat për vitin 2014, të paraqitura në tabelë, e tregojnë shumën totale të ndihmës shtetërore të ndarë për vitin 2014, duke e paraqitur në kategori të ndryshme, të shprehura në denarë dhe euro.

Kategoritë për të cilat ndihma shtetërore është ndarë në vitin 2014 janë: përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; Përkrahja dhe zhvillimi i grupimit kllasterik; implementimi i politikës industriale; turizmi (manifestime turistike dhe forume; restorante-kafene nacionale); punësim; përkrahje financiare e subjekteve juridike; përgatitje për punësim përmes trajnimeve; promovimi dhe përkrahja e turizmit për subvencionimin e qarkullimit të huaj turistik të organizuar dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Në vitin 2014, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës miratoi vendime pas parashtrimit të Njoftimit për ndihmë të planifikuar shtetërore për zhvillim regjional nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore. Vendimet e këtilla, të treguara në tabelën e mësipërme, janë vendime të miratuara nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës për ndarje të planifikuar të ndihmës shtetërore regjionale, e cila si e tillë është në përputhje me qëllimet e politikës regjionale të Republikës së Maqedonisë, duke mbështetur investimet produktive fillestare ose hapjen e vendeve të reja të punës lidhur me investimet. Nga ajo që u tha mund të konstatohet se edhe në vitin 2014, vazhdon investimi i investitorëve të huaj në republikën e Maqedonisë, sidomos në zonat zhvillimore teknologjike industriale, me qëllim të përmirësimit, rritjes më të shpejt dhe zhvillimit ekonomik në vend.

Nga të dhënat e vitit 2014 mund të konkludohet se pjesëmarrja e ndihmës shtetërore në vitin 2014 krahasuar me BPV është 0,08%. Shuma e përgjithshme e ndihmës shtetërore e cila është ndarë në këtë vit është 448.277.000,00 denarë.

Gjithashtu, nga të dhënat e vitit 2014 mund të konkludojmë se me shumicën e dhënësve të ndihmës shtetërore është vendosur kontinuitet në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga implementimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore, dhe kjo mundëson vlerësimin e pandërprerë, kontrollin dhe mbikëqyrjen nga ana e Komisionit të ndihmës së tillë shtetërore në ato zona.

6.2 Ndhma shtetërore sipas instrumenteve

Në lidhje me instrumentet me të cilat është ndarë ndihma shtetërore për të cilën janë dorëzuara njoftime- notifikime dhe për të cilën është miratuar një vendim nga Komisioni në periudhën 2014, mund të konkludohet se ndihma shtetërore e ndarë në vitin 2014, është ndarë nëpërmjet instrumenteve të grupit A.

6.3 Mendimet e Komisionit

Në vitin 2014, numri i mendimeve të dhëna nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është 19. Numri i madh i mendimeve të cilët Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i kishte miratuar gjatë vitit 2014, është për shkak të nevojës së dhënësve të



ndihmës shtetërore të marrin një mendim nga Komisioni qysh në fazën e përgatitjes së akteve nënligjore, të cilat në vetvete mund të përmbajnë elemente të ndihmës shtetërore, si dhe për nevojën e vlerësimit të propozim marrëveshjeve për ndarje të ndihmës regjionale shtetërore për shfrytëzuesit potencial.

7. Komentet dhe konkluzionet

Është i dukshëm trendi i kërkesës së vazhdueshme të mendimeve dhe njoftimeve të dorëzuara-notifikimeve që vijnë nga ministritë, që është një rezultat i rritjes së konsiderueshme të vetëdijes për rëndësinë që e ka kjo zonë, si një pjesë e rëndësishme e fushës së mbrojtjes së konkurrencës dhe ndryshimeve të paraqitura në legjislacion. Në të njëjtën kohë, Komisioni është në komunikim të vazhdueshëm jo formal me të gjithë dhënësit e ndihmës shtetërore që kanë nevojë për ndonjë informacion në lidhje me masat e planifikuara për ndarje të ndihmës shtetërore nga dhënësit. Gjithashtu, jo më pak i rëndësishëm është edhe zbatimi i drejtë i legjislacionit për ndihmë shtetërore për integrimet evropiane.

Të dhënat për ndihmën e ndarë shtetërore në Republikën e Maqedonisë në vitin 2014, flasin se ndihma shtetërore në masë të madhe është ndarë për përkrahjen projekteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomin e shtetit, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të projekteve që nxisin zhvillimin ekonomik të zonave në Republikën e Maqedonisë, ku standardi i jetesës është i ulët ose ka papunësi të lartë. Domethënë, bëhet fjalë për ndihmën e ndarë shtetërore për zhvillim regjional me të cilën përkrahen investimet e huaja në vend, nëpërmjet subvencionimit të kompanive të cilat investojnë në Republikën e Maqedonisë.

Nga ana tjetër, përmes programeve të zhvillimit, shteti ka marrë pjesë nëpërmjet mekanizimit të ndihmës shtetërore në përkrahjen dhe zhvillimin e turizmit, ku si dhënës të ndihmës e hasim Ministrinë e Ekonomisë dhe Agjencinë për promovim dhe përkrahje të turizmit. Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë përmes Propozim- Programit për konkurrencë, inovacione dhe ndërmarrësi në vitin 2014 u paraqitë si një dhënës i ndihmës shtetërore për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zbatimin e politikës industriale, si dhe në përkrahjen dhe zhvillimin e grupimit kllasterik. Shteti gjithashtu përmes ndarjes së ndihmës shtetërore ndihmoi edhe në disa pjesë të masave të Planit operativ për programet aktive dhe masat për punësim për vitin 2014, ku si dhënës i ndihmës shtetërore paraqitet Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në këtë kontekst, shteti nëpërmjet ndarjes së ndihmës shtetërore nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë, ndihmoi në mbrojtjen e mjedisit jetësorë nëpërmjet të zbatimit të masave konkrete, që janë pjesë përbërëse e Programit për Mbrojtjen e mjedisit jetësorë për vitin 2015.

Gjithashtu, duhet të theksohet edhe komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me dhënësit e ndihmës shtetërore që kanë për qëllim të ndajnë ndihmë regjionale në zonat zhvillimore teknologjike-industriale. Domethënë, të gjitha propozim- marrëveshjet për ndarje të ndihmës shtetërore të cilat lidhen ndërmjet shfrytëzuesit potencial të ndihmës shtetërore dhe dhënësit të ndihmës shtetërore paraprakisht marrin pëlqimin e



Komisionit, në lidhje me tekstin e të njëjtit, ndërsa në fushën e kompetencave nga ana e Komisionit.

Duhet të theksohet se në një numër të vogël të dhënësve të ndihmës shtetërore ende mungon kryerja e obligimeve për dorëzimin në kohë të raportit vjetor për ndihmën shtetërore të ndarë për vitin e kaluar, ku me këtë minohen mekanizmat e vendosura ligjore për mbikëqyrje. Komisioni, si një organ që merr përsipër mbikëqyrjen dhe kontrollin e ndihmës shtetërore, ndërmerr aktivitete për të kapërcyer këto probleme dhe pritet që në të ardhmen, bashkëpunimi me të gjithë dhënësit e ndihmës shtetërore të jetë në nivelin e kërkuar. Komisioni mirëpret dukurinë e thirrjeve të shpeshta të përfaqësuesve të Komisionit, në përgatitjen e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike.

Megjithatë, dhënësit e ndihmës shtetërore tregun gatishmëri, përmes konsultimeve me Komisionin në baza ditore, në kohë dhe saktësisht ti dorëzojnë njoftimet deri te Komisioni.

V. INTEGRIMI NË UE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në vijim janë përshkruar aktivitetet e Komisionit në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në vitin 2014, në lidhje me procesin përafrimit në Unionin Evropian, projektet për ndihmë teknike të Unionit Evropian në të cilat Komisioni është shfrytëzues, si dhe bashkëpunimi bilateral dhe multilateral dhe pjesëmarrja e punonjësve të Komisionit në seminare dhe konferenca ndërkombëtare.

8. Integrimi në UE

8.1 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2014 në fushën antitrust dhe ndihmën shtetërore

Në fushën antitrust (marrëveshje të ndaluara dhe keqpërdorimi) dhe përqendrimit, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës miratoi dy vendime për marrëveshjet anti-konkurrese, katër për keqpërdorimin e pozitës dominuese dhe tetëmbëdhjetë për përqendrimit. Nëntë procedura janë në vijim. Gjykata Administrative anuloi (refuzoi) shtatë vendime të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për arsye procedurale, gjashtë prej të cilave janë konfirmuar më pas nga Gjykata e Lartë Administrative. Kodi Penal është harmonizuar me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili lejon të zbatohen masat leniency. Udhëzimet për kufizimet vertikale dhe marrëveshjet horizontale janë miratuar, me të cilët sigurohet harmonizim i mëtutjeshëm i legjislacionit për konkurrencë me atë UE-së. Analiza e tregut në sektorin bankar është bërë në vitin 2013. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bashkëpunim me Akademinë e Gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, zhvilloi një trajnim në fusha të veçanta për gjyqtarët dhe bashkëpunëtorëve profesional të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Nga 2012 e këndej, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk ka



miratuar asnjë vendim mbi kartelet. Buxheti i tij operativ mbetet i kufizuar dhe vazhdon në mënyrë të pamjaftueshme ta shfrytëzon kapacitetin administrativ në fushën antitrust dhe përqendrimet.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka miratuar gjashtë vendime për aprovimin e ndihmës shtetërore të ndarë (për skema dhe ndihma individuale), dy prej të cilëve për ndihmë shtetërore regjionale. Kapaciteti i sektorit për kontrollin e ndihmës shtetërore është forcuar dhe numri i të punësuarve është përkatës. Vetëdija ndërmjet dhënësve të ndihmës shtetërore për dorëzim të njoftimit për shfrytëzimin e ndihmës shtetërore mbetet e ulët, duke i prishur mekanizmat e monitorimit që janë në zbatim. De minimis pragu prej 200,000 euro është tepër i lartë dhe në disproporcion me tregun (ekonominë) e vendit dhe përbën një rrezik për prishjen e konkurrencës. Duke shikuar në tërësi, korniza juridike për ndihmën shtetërore mbetet stabile, por transparenca në aspektin detajeve dhe shumave të ndihmës shtetërore të ndarë duhet të përmirësohet.

Konkluzë

Në fushën e politikës konkurruese është bërë një progres i mirë. Legjislacioni në mënyrë plotësuese është harmonizuar me legjislacionin evropian dhe Kodi Penal është harmonizuar me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Zbatimi i legjislacionit sipas numrit dhe kushteve mbahet në nivel të njëjtë. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vazhdon të operon me buxhet të pamjaftueshëm, ndërsa numri i të punësuarve është i mjaftueshëm. Duke shikuar në tërësi, përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë të avancuar”.

8.2 Bashkëpunimi ndër-dikasterial në planin e integritit evropian

Komisioni është bartës i Grupit të Punës NPAA 3.08 Politika e konkurrencës edhe me këtë kapacitet është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme në planin legjislativ dhe institucional për kapitullin 08 Politika e konkurrencës në drejtim të plotësisht të kushteve për anëtarësimin e RM-së në UE. Komisioni rregullisht ka marrë pjesë në mbledhjet mujore të Komitetit të Punës për Integrim Evropian (KPIE) dhe Nën-komitetin e KPIE në Sekretariatit për çështje evropiane (SÇE). Në këto takime, kryesuesit e SÇE-së, Komisioni rregullisht informonte për arritjen e përparimit në planin e harmonizimit të legjislacionit nacional me UE asquis dhe përforcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit, si dhe për shkallën e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në kapitullin 08 të Programit Nacional për miratimin e të drejtës së UE-së për 2014-2016 (NPAA 2014-2016). Si një bartës i kapitullit 8 Politika e konkurrencës, Komisioni kryesonte me takimet e rregullta mujore të grupit të punës ndër-dikasterial NPAA3.08 Politika e konkurrencës, në të cilët shikohej përparimi i arritur, aktivitetet e planifikuara dhe shkëmbeheshin informacione relevante në kapitullin me anëtarët e këtij grupi (organet shtetërore të cilët me aktivitetet e tyre kanë ndikim mbi aktivitetet ekonomike dhe shkallën e zhvillimit të konkurrencës dhe vëllimin e ndarjes së ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë). Komisioni deri te SÇE, rregullisht



i dorëzonte raportet e kërkuara për përparimin e arritur në kapitullin 08 (mujore, tremujore dhe gjysmë-vjetore).

Më 26-27.03.2014, në Shkup u mbajt takimi i 10-të i Nën-komitetit për tregun e brendshëm dhe konkurrencën ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionin Evropian. Ky nën-komitet është pjesë e strukturës, e vendosur në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësive Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare. Në takim, Komisioni e prezantoi përparimin e arritur në kapitullin 3.08 në bazë të materialit të përgatitur paraprakisht me shkrim para përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe Delegacionit të UE-së në Shkup, ku mori komente dhe sugjerime përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vend në kuptim të këtij kapitulli. Takimi i 11-të i Nën-komitetit për tregun e brendshëm dhe konkurrencë do të mbahet në vitin 2015.

Në tremujorin fundit të vitit 2014, Komisioni në mënyrë aktive mori pjesë në procesin e revizionit të NPAA, ku përgatitu kapitullin 3.08 të Programit Nacional për miratimin e të drejtës së UE-së për vitin 2015-2017 (NPAA2015-2017). Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi NPAA 2015-2017 në dhjetor të vitit 2014 dhe e njëjta është në dispozicion në faqen e internetit të SÇE-së. Në vitin përfundoi Twining projekti „ *Përkrahja e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore*”, i financuar nga IPA komponenti 1 për vitin 2009. Ky Twining projekt në pjesën legislative ndër të tjera ka kontribuar për miratimin e rregulloreve të reja si në vijim, Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës regjionale dhe Rregullorja për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale, brenda të cilit janë inkuorporuar dhe një pjesë për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik. Përveç kësaj, me një sërë trajnimesh punohej në përfundimin e kapaciteteve të Komisionit dhe aktorëve të tjerë në zbatimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore. Gjithashtu, projekti kontribuoi në ngritjen e vetëdijes publike të ndihmës shtetërore. Twining partnerët ishin Ministria e Biznesit, Inovacionit dhe shkathtësisë e Britanisë së Madhe.

Në qershor të vitit 2014 filloi projekti për „ Zbatimin e politikës së mbrojtjes së konkurrencës dhe ndihmës shtetërore të UE-së në Maqedoni”, **përfituesi kryesor** i të cilit është Komisioni. Projekti është financuar nga Ambasada Britanike në vend, ka një buxhet total prej £30,940 dhe do të zbatohet nga qershori i vitit 2014 deri në prill 2015. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar shumë trajnime për punonjësit në Komision për zbatimin e programit për butësi (leniency program), kryerjen e hetimeve dhe mbledhjen e provave në vendngjarje dhe vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore. Deri në përfundimin e tij, do të përpilohet një metodologji për mbledhjen e provave në vendngjarje gjatë kryerjes së kontrolleve nga personat e autorizuar në komision, dhe do të mbahet trajnim në dhomat e ekonomisë për të drejtat dhe detyrimet e tyre që janë në përputhje me LMK-në.

9. Bashkëpunimi ndërkombëtar

9.1 Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral



Gjatë vitit 2014, ka vazhduar dhe është rritur bashkëpunimi me organet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të konkurrencës në vendet e regjionit dhe vendet anëtare të UE-së, e filluar në vitet e mëparshme, gjithashtu janë iniciuar edhe projekte të reja në kuadër të organizatave ndërkombëtare.

9.2 Bashkëpunimi bilateral

Në vitin 2014, në mënyrë intensive u realizua bashkëpunimi bilateral me organet e mbrojtjes së konkurrencës të vendeve të rajonit, ku dhe më tutje paraqet një element të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërkombëtar të Komisionit, duke u bazuar në shkëmbimin e përvojave të ndryshme në çështjet e aderimit të këtyre vendeve në Unionin Evropian, por edhe në proceset dhe përshtatjet e ekonomisë së tregut në një kuptim më të gjerë.

9.3 Bashkëpunimi multilateral

Në shkurt të vitit 2005, u formua OECD(Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)- Qendra Rajonale për Konkurrencë (QRK) në Budapest, Republika e Hungarisë, në kuadër të cilit organizohen seminare dhe trajnime për punonjësit e organeve kompetente të konkurrencës në vendet e Evropës Juglindore. Punonjësit e Komisionit në vitin 2014 morën pjesë në 4 seminare/punëtori të cilët u organizuan nga OECD- QRK në tema të ndryshme në fushën e mbrojtjes së konkurrencës- marrëveshjeve të kufizuara, keqpërdorimin e pozitës dominuese dhe përqendrimeve. Gjithashtu, në periudhën 3-5 qershor 2014, në Hotelin Arka, Shkup u mbajt „ Seminar mbi kartelet në furnizimet publike”, i organizuar nga OECD- Qendra Rajonale për konkurrencë në Budapest, në bashkëpunim me Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku ishin të pranishëm ekspertë të politikës së konkurrencës nga OECD, Franca, Rumania, Finlanda dhe Hungaria. Gjithashtu, pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësues të organeve të konkurrencës nga disa vende si: Shqipëria, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Bjellorusia, Kirgistani, Kazakistani, Kosova, Moldavia, Armenia, Serbia, Ukraina, Kroacia, Rusia dhe Rumania.

Republika e Maqedonisë është anëtare e ICN-së (Rrjeti Ndërkombëtarë për Konkurrencë) dhe në vitin 2014, Komisioni mori pjesë aktive në punën e ICN-së dhe ishte pjesëmarrëse në konferencën vjetore. ICN ndihmon në afrimin e qëndrimeve të vendeve të zhvilluara dhe vendet në zhvillim për çështjet që lidhen me rëndësinë e rregullimit efektiv të konkurrencës për zhvillimin e suksesshëm të ekonomive nacionale, tërheqjen e investimeve në vendet dhe plotësimin e plotë të kërkesave të konsumatorëve, me theks të veçantë, nevojën e vazhimit të ngritjes së kulturës konkurruese dhe të gjitha aktiviteteve që promovojnë ligjin dhe politikën e konkurrencës nëpërmjet mekanizmave jodetyruese, edukimit përkatës dhe specializimin e gjyqësorit në këtë fushë.



G. KAPACITETI ADMINISTRATIV I KOMISIONIT

Punët profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, materiale-financiare, kontabiliste, informatike dhe punët e tjera administrative-teknike, i kryen shërbimi profesional i Komisionit.

Më 31.12.2014, numri i punonjësve në Komision arriti në 27-të, duke përfshirë Kryetarin dhe dy anëtarët, të cilët janë të angazhuar profesionalisht në punën e Komisionit. Të punësuarit në shërbimin profesional e kanë statusin e nëpunësve shtetërorë. Nga 24 të punësuar në shërbimin profesional, 18 janë me arsim të lartë, 5 janë me arsim të mesëm dhe 1 me arsim fillor.

Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, të punësuar në Komision është 12 persona, gjegjësisht 42,86%.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve që punojnë në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës është 5, të gjithë janë me arsim të lartë, ndërsa në zbatimin e Ligjit për kontrollin e Ndhmës Shtetërore punojnë 5 të punësuar, të gjithë janë me arsim të lartë.

C. KONKLUZË

Komisioni në kuadër të kompetencave të tij në vitin 2014, përveç numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në shërbimin profesional dhe mjeteve të pamjaftueshme financiare, me sukses i kreu punët mbi harmonizimin dhe përshtatjen e legjislacionit në fushën e konkurrencës me të drejtën e UE-së.

Mbrojtja e konkurrencës paraqet një problematikë ligjore që vazhdimisht ndryshohet dhe plotësohet edhe në Unionin Evropian, prandaj monitorimi dhe përshtatja e legjislacionit të Maqedonisë me atë të UE-së, paraqet një proces të vazhdueshëm dhe detyrë të Komisionit deri në arritjen e anëtarësimit në UE.

E dyta, detyrë jo më pak e rëndësishme e Komisionit, është aplikimi dhe zbatimi i rregullave të miratuara në atë mënyrë që do të mundësonte krijimin e një ekonomie të tregut, në të cilën vlejnë rregullat e njëjta për të gjithë subjektet ekonomik në tregun e Maqedonisë, pa marrë parasysh fuqisë së tyre ekonomike.



Përgjegjësinë për zbatimin efikas të legjislacionit tashmë të harmonizuar në fushën e konkurrencës nuk e ka vetëm komisioni, por edhe Gjykata Administrative e cila vendos për ligjshmërinë e vendimeve të saj.

Komisioni duhet edhe në të ardhmen ti kryejë detyrat e caktuara që lidhen me përcaktimin e Republikës së Maqedonisë për t'u bërë anëtare e plotë e Unionit Evropian, sepse fusha e mbrojtjes së konkurrencës dhe zbatimi i kësaj dege të së drejtës në praktikë, është qëllimi kryesor i Unionit Evropian. Në lidhje me këtë, është i nevojshëm një përforsim i vazhdueshëm institucional i Komisionit, kryesisht duke rritur numrin e të punësuarve. Të gjithë të punësuarit e Komisionit duhet në mënyrë të vazhdueshme të përsosën ose të fitojnë njohuri të reja, që do të jenë të gatshëm edhe sot, në procedurat konkrete të cilët i udhëheqin, ti zbatojnë standardet evropiane. Komisioni ka nevojë për një rritje të vazhdueshme të numrit të kuadrit me arsim të lartë, kryesisht në fushën e shkencave juridike dhe ekonomike, të cilët do të kenë një njohuri të mirë të ligjit dhe praktikës evropiane në fushën e konkurrencës dhe njohje të gjuhës angleze, dhe për realizimin me sukses të qëllimeve të përcaktuara dhe detyrat në një mbrojtje më efektive të konkurrencës së tregut.

Deri tani ajo që u potencua e konfirmojnë edhe mendimet e Komisionit Evropian të shprehura në raste të ndryshme me përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë, që në lidhje me çështjet në fushën e konkurrencës është bërë një progres i rëndësishëm, por kjo nuk do të thotë se edhe më tutje nuk duhet të bëjmë përpjekje më qëllim të harmonizimit të së drejtës me UE-në dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim.

Mjetet për punën e Komisionit sigurohen nga Buxheti i RM-së.



Gj. RAPORTI FINACIAR për periudhën 01-01 deri më 31-12.2014
për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës
në llogarinë buxhetore 20056013563716

Buxheti i Komisionit për vitin 2014	16.933.175,00
Të ardhurat nga 01.01.2014 deri 31.12.2014	16.933.175,00

Të ardhurat e realizuara sipas planeve të miratuara nga buxheti i RM-së dhe zyra e trezorit. Sipas planit të miratuar theksojmë se të dalat janë të realizuara në bazë të nevojave, dhe sipas kontës së miratuar në bazë të planeve të Buxhetit të RM-së dhe trezorit.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë operimit të tij në vitin 2014 deri më 31.12.2014, ka bërë shpenzimet e mëposhtme, të cilët janë paguar nga mjetet në dispozicion që i kishte në llogarinë e buxhetit.

1. Të ardhurat e buxhetit të R. Maqedonisë

	Të ardhurat për pagat	13.288.175,00
	Të ardhurat për udhëtime dhe mëditje	500.000,00
	Shpenzimet komunale	2.000.000,00
	Të ardhurat për materiale të ndryshme	100.000,00
	Mirëmbajta	45.000,00
	Shërbimet kontraktuese	700.000,00
	Reprezentacione të ndryshme	300.000,00
Totali	Të ardhurat për 2014	16.933.175,00

2. Të dalat

401	Pagat dhe mëditjet	9.695.657,00
402	Kontributet për sigurim social	3.592.518,00
420	Udhëtimet dhe të dalat ditore	495.453,00
421110	Shërbime komunale të rrymës	227.566,00



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS



Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk

421120	Shërbime komunale për furnizim me ujë	145.521,00
421130	Hedhja e mbeturinave	89.792,00
421190	Taksa tjera komunale	19.640,00
421210	Ngrohje qendrore	590.297,00
421310	Shpenzim PTT	20.772,00
421320	Telefon	469.193,00
421390	Shpenzimet e komunikimit	2.840,00
421410	Karburante dhe vajra	94.613,00
421420	Kontrolli teknik	14.811,00
421430	Transporti i mallit	28.693,00
421440	Transporti i personave	218.567,00
421		1.922.305,00
423110	Material për zyra	28.342,00
423120	Mjetet për revista	18.180,00
423190	Materiale tjera administrative	150,00
423210	Materiale për PADH kompjuterave	8.089,00
423710	Mjetet për higjienë	16.001,00
423990	Materiale tjera	2.420,00
423		73.182,00
424110	Riparimi dhe kontrolli i Automjeteve	22.362,00
424420	Riparimi dhe mirmbajta e softuerit	13.800,00
424440	Riparimi i makinave	8.000,00
424		44.162,00
425130	Marrje me qira një lloj tjetër të hapsirës	211.155,00
425220	Provizion bankar	9.070,00
425310	Shërbime juridike	10.140,00
425360	Taksat gjyqësore- personat juridikë	4.198,00
425910	Shërbime për përkthim	1.841,00
425920	Printim	4.383,00
425990	Shërbime të tjera kontraktuese	457.152,00
425		697.939,00
426210	Reprezentacione	710,00
426410	Shpallje në gazeta	31.118,00
426990	Shpenzime të tjera operative	266.834,00
426		298.662,00
	Shpenzimet totale për vitin 2014	16.819.878,00

Totali i të
ardhurave
të

planifikuara..... 16.933.175.00



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



Të dalat totale..... 16.819.878,00

Zbatimi i të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara i shprehur në përqindje është 99.33%

VËREJTJE: Në vitin vijues 2014, Komisioni nuk i ka shlyer detyrimet ndaj këtyre furnizuesve me një borxh të përgjithshëm prej 387.378,00 den.

Emir I furnizuesit	Shuma
Kërkesa e punës. Udhëtime jashtë vendit	5.872,00
Ujësjiellësi dhe kanalizimi- uji	7.208,00
Higjiena komunale- mbeturinat	15.861,00
Riko Mak aparat për kopje- servis	2.070,00
Byroja për furnizime publike	2.124,00
I-12 Soft	12.000,00
EVN Maqedonia- rryma	14.992,00
Telekomi i Maqedonisë- fiksi	20.018,00
T-mobile- celular	43.088,00
IN- taksi	19.028,00
Sekjurikom multiservis	1.770,00
NP Gazeta Zyrtare	68.800,00
Veçor	28.302,00
Media print Makedonia	40.210,00
Lajm	20.366,00
Euroimpeks	14.810,00
Virtus Elias	325,00
Ballkan Enerxhi	68.264,00
TRD Robi SHPKNJP- Telekabel	1.700,00
NP MRT trd	570,00
Totali i borxhit për vitin 2014	387.378,00

Puna financiare e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, mjetet nga llogaria e donatorëve – xhirollogaria 020056013578721 për një periudhë prej 01.01.2014 deri 31.12.2014



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



1. Të ardhurat nga llogaria e donatorëve e Ambasadës Britanike

	Të ardhurat nga llogaria e donatorëve	1.515.326,00
--	---------------------------------------	--------------

2. Të dalat

420130	Udhëtimet dhe shpenzimet ditore	16.385,00
420220	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	31.774,00
423110	Materiale për zyra	23.010,00
425220	Provizion bankar	1.938,00
425970	Shërbime konsultative	468.731,00
425990	Shërbime të tjera kontraktuese	296.065,00
	Shpenzimet totale për vitin 2014	838.353,00

Të ardhurat në vitin 2014 1.515.326,00

Të dalat në vitin 2014 838.353,00

Bartja në vitin 2015 e shumës së mbetur 676.973,00

është e rezervuar për vazhdimin e aktiviteteve tashmë të filluara të projektit në vitin 2014, që vazhduan edhe në vitin 2015.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk

